

DETYRA SHITESË PËR NJËSINË MËSIMORE 2

PARAQITJA DHE STEREOTIPIZIMI NË MEDIA

Detyra 1 (për arsimin fillor dhe të mesëm): Ndikimi i informacioneve të mëparshme në krijimin e paraqitjeve për realitetin

Materiale të nevojshme:

Shih figurën nr. 1 (A, B dhe C) (në materialet audiovizive shitesë në CD)

Përshkrimi i detyrës:

Gjysmës së nxënësve iu tregohet Figura A, ndërsa pjesës tjetër Figura B. Secili nxënës rreth 10 sekonda duhet ta vështrojë figurën përpara vetes. Pastaj arsimtari tërë klasës ia tregon Figurën C dhe kërkon që çdo nxënës përmes diskutimit të hapur të tregojë se çka sheh në Figurën C.

Përvoja e gjertanishme me përdorimin e kësaj detyre (në kontekste të ndryshme) tregon se pothuajse të gjithë që e kanë parë Figurën A, kur e shikojnë Figurën C, së pari e vërejnë gruan e re, ndërsa ata që e kanë parë Figurën B, së pari e shikojnë plakën. Gjithsesi se ekzistojnë edhe përjashtime nga kjo rregull, kështu që po u paraqitën ato gjatë orës, mund të tregohen si përjashtime.

Tema për diskutim:

Arsimtari duhet ta udhëheq dhe ta drejtojë diskutimin, ashtu që t'u ndihmojë nxënësve vetë të vijnë dhe të tregojnë me fjalë se si informacioni i mëparshëm ndikon ndaj perceptimit. Pasi të vihet në këtë konkluzion, arsimtari duhet që me ndihmën e pyetjeve ose të komenteve nxënësve t'u ndihmojë që diskutimin ta zgjerojnë dhe të përfshijnë edhe ndikimin e mediave në perceptimin e realitetit përmes reprezentacioneve që i krijojnë.

Në ndihmë mund të kenë theksimin e faktit se Figurat A dhe B janë një lloj reprezentimi i Figurës C, për shkak se në vete paraqesin pjesë të elementeve të Figurës C. Në të njëjtën mënyrë veprojnë edhe reprezentacionet e mediave. Për shembull, kur njoftojnë për një ngjarje të caktuar, ato transmetojnë një numër të kufizuar informacionesh për atë ngjarje dhe me këtë e “ngjyrosin” perceptimin për këtë ngjarje.

E njëjta detyrë mund të shfrytëzohet për demonstrim se dy të rinj mund të shikojnë të njëjtën gjë (Figura C), të mos pajtohen rreth asaj se çka shikojnë (grua të re ose plakë) dhe të dy të jenë në të drejtë.

Pyetje hyrëse që i drejtohet njërit prej nxënësve, të cilit i është dhënë Figura A:

1. Çka shikon në këtë figurë (C)? (përgjigje e supozuar - gruan e re)
2. A shikon ndokush tjetër diçka më ndryshe në këtë figurë (C)? (Arsimtari zgjedh nxënësin të cilit më parë i është dhënë Figura B)
3. Sa prej jush me shikimin e parë të Figurës C në të kanë vërejtur gruan e re? Sa prej jush kanë vërejtur plakën?
4. Sa prej jush që patë gruan e re, e shikuat Figurën A? A mendoni që, meqë më parë e shikuat Figurën A, ajo të ketë ndikuar që të njëjtën figurë ta vëreni edhe te Figura C? (dhe e kundërta, për grupin tjetër të nxënësve)
5. A mund të kujtoni situata të njëjta, kur diçka të cilën më parë e keni dëgjuar ose e keni parë, të ketë ndikuar në atë që pastaj, më vonë, e keni parë, e keni dëgjuar, e keni menduar? (po qe se nga çfarëdo shkaqesh nxënësit nuk mund të kujtojnë situata të këtilla, arsimtari mund të bashkëpërfjetojë tregimin e vet)

Qëllimi i detyrës: Përmes këtyre aktiviteteve nxënësit:

-do të shohin ndikimin e përvojës së mëparshme (informacionin) në perceptimin e aspekteve të realitetit.

Detyra 2 (për asimin fillor e të mesëm): Hulumtimi i stereotipave etnikë

Materialet e nevojshme:

-detyra përfshin 5 fotografi: 1. maqedonasin, 2. shqiptarin, 3. turkun, 4. Sotir Mitrevin, 5. Xhaxhi Zendelin (shih materialin audioviziv plotësues në CD).

Përshkrimi i detyrës:

Nxënësit duhet të ndahen në grupe. Secilit grup i jepet nga një prej fotografive 1, 2 dhe 3. Secili grup duhet t'i shikojë ato dhe të japë një përshkrim të shkurtër për fytyrat në fotografi.

Pyetjet që mund t'u jepen për të udhëhequr përshkrimin janë këto:

1. Si quhen këta dy burra?
2. Cilit grup etnik i takojnë?
3. Theksoni disa prej profesioneve, për të cilat supozoni se këta dy burra i kanë.
4. Ku jetojnë?
5. Cilat karakteristika do t'ua kishit përshkruar?

Pasi të ketë mbaruar kjo pjesë e punës, secili grup duhet ta tregojë fotografinë dhe duhet t'i bashkëpërfjetojë përgjigjet e veta me tërë klasën.

Tema për diskutim:

Ç'është ajo që ju çoi që t'i theksoni ato emra dhe atë përcaktim etnik të njerëzve?

A ndikoi ky element në të gjitha përgjigjet tuaja?

A do të ishit përgjigjur njësoj sikur ai element të mos ekzistonte në fotografi?

Si do të ndiheshe po qe se edhe ty të vlerësojnë sipas stereotipit të grupit etnik që i takon?

Prej ku marrim ide që kontribuojnë te stereotipat për njerëzit për nga përkatësia tjetër etnike?

Në fund të detyrës, arsimtari duhet t'ua tregojë fotografinë numër 4, të Sotir Mitrevit, dhe t'u tregojë se ajo është fotografi origjinale, e marrë nga një gazetë jona ditore, si dhe fotografitë me të cilat ata kanë punuar janë përpunuar me ndihmën e softuerit për përgatitjen e fotografive. Menjëherë pastaj u tregon fotografinë numër 5, të Xhaxhi Zendelit, e cila gjithashtu është marrë nga një gazetë jona ditore. Iu theksohet nxënësve se këta dy njerëz ekzistojnë, nuk janë të trilluar, dhe mund të vërejnë se midis tyre nuk ka dallime të mëdha, thuhet janë vëllezër ose kushërinj. Ndërkohë që ata u takojnë dy bashkësive të ndryshme në Maqedoni. Me këtë arsimtari u tregon nxënësve se, në realitet, jo përherë ekzistojnë dallime të mëdha midis maqedonasve dhe shqiptarëve, ndërsa në raport me grupet etnike të cilave u takojnë ekzistojnë paragjykime të cilat jo rallë krijohen ose forcohen me paraqitjet në media.

Si detyrë shtëpie mund t'u jepen që të bëjnë poster me paraqitje stereotipe të bashkësive etnike në media, përfshi edhe për vete dhe për grupin e vet etnik.

E njëjta mund të bëhet me cilëndo fotografi e cila vlerësohet si më adekuate.

Detyra 3 (për arsimin fillor e të mesëm): Thyerja e stereotipave

Materialet e nevojshme:

-letër hamer

-selotejp

-gërshërë

Përshkrimi i detyrës:

Jo të gjitha pamjet shfrytëzojnë stereotipa. Në këtë detyrë nga nxënësit kërkohet që të bëjnë poster, i cili e tregon dallimin midis pamjeve të stereotipizuara dhe pamjeve të pastereotipizuara.

Nxënësit duhet të dahen në grupe prej 3 deri në 4 veta dhe duhet të zgjedhin një stereotip që është i pranishëm dhe i forcuar nga ana e mediave (mund të përdoren disa prej të cilave janë dhënë si shembull më poshtë në tekst). Secili grup duhet të ketë nga një letër hamer, të cilën do ta ndajë me vizore në dy pjesë (në dy kolona). Njëra pjesë do të bart emrin “pamje të stereotipizuara”, ndërsa e dyta “pamje të pastereotipizuara”. Nxënësit duhet që nga revistat të gjejnë dhe të presin fotografitë të cilat do t’i ngjesin në letrën hamer në kolonën adekuate, varësisht nga ajo se, sipa tyre, a janë pamje që ruajnë stereotipa ose jo. Pasi të kenë mbaruar, letrën hamer duhet ta ngjesin lart, që të mund ta shoh e tërë klasa.

Shembuj tregimesh –pamjesh stereotipe në media:

1.Shumë revista i paraqesin nënat se si shërbejnë ushqimin në familje, mirëpo shumë pak i tregojnë baballarët që e bëjnë këtë. Këto tregime duket se sugjerojnë se nënat (gratë) janë ato që i kryejnë të gjitha punët që lidhen me amvisërinë dhe përgatitjen e ushqimit dhe ata kënaqen me këtë. Disa, megjithatë, nuk kënaqen me këto punë. Disa burra, ndërkaq, kënaqen me përgatitjen e ushqimit. (stereotip gjinor)

2.Shumë fotografi në gazeta, filma dhe programe televizive i paraqesin burat të përfshirë në ndonjë aktivitet fizik, si për shembull sport, ngjitje në shkrepë ose vozitje në kanu, ndërsa shumë pak i paraqesin gratë në aktivitete të këtilla. (stereotip gjinor)

3. Shumë fotografi në revista dhe reklama paraqesin tinxhere që rregullohen, që vënë grim, që i krehin flokët dhe kujdesen për pamjen e tyre, mirëpo shumë pak i paraqesin djemtë se si i bëjnë gjërat e tilla. (stereotip gjinor)

4. Shumë spote reklamash televizive tregojnë se si djemtë luajnë me nintenda, plej-stejshën, me kamiona dhe super-heronj, mirëpo nuk i paraqesin vajzat se e bëjnë këtë. (stereotip gjinor)

5. Shumë shpesh në media romët paraqiten si lypës dhe pastrues të xhamave të veturave, mirëpo nuk paraqiten ata që punojnë si doktorë, profesorë, tregtarë, gazetarë. (stereotip etnik)

Revistat personat zeshkanë shumë shpesh i paraqesin si sportistë, në të shumtën e rasteve si basketbollistë, të verdhët si karatistë dhe kunfuistë etj.

Detyra 4 (për asimimin fillor e të mesëm): Stereotipat gjatë paraqitjes në media–stereotipat etnikë

Materialet e nevojshme:

-gazetë ditore ose TV

-fletë letre

Përshkrim i detyrës:

Nxënësve do t'u jepet detyrë shtëpie që të shfletojnë një gazetë ditore të cilën ata do ta zgjedhin dhe të vërejnë se sa herë është përmendur ndonjëra prej bashkësive etnike minoritare (për shembull, shqipëtarët, romët), në cilat rubrika dhe a është paraqitur në dritë pozitive apo negative.

Në orë pastaj token përvojat dhe zhvillohet diskutimi, qëllimi i të cilit është t'i tregojë stereotipizimet në reprezentacionet në media. E njëjta mund të bëhet duke ndjekur TV-ditarin.

Plotësimi i detyrës: Në orë diskutimi mund të fillojë duke treguar shembullin e Shoqatës nacionale të Gazetarëve Hispanikë. Përfundimi i detyrës a e reflekton edhe të njëjtën në kontekstin tonë?

Shembulli 1. Shoqata nacionale e Gazetarëve me Prejardhje Hispanike, në raportin e saj të vitit 2000 njofton se:

“Nga 12.000 storje në orët e mbrëmjes që gjtë vitit emetohen në tri rrjete të mëdha amerikane, vetëm 1 % lidhen me njerëzit me prejardhje hispanike. Atëherë, kur bëhet fjalë për ta, ata në 80 % të kohës janë të portretuar negativisht”.

Burimi: Shoqata nacionale e Gazetarëve me Prejardhje Hispanike (National Association of Hispanic Journalists).

Detyra 5 (për asimin fillor e të mesëm): Subjektiviteti në zgjedhjen e informacioneve

Përshkrimi i detyrës:

Nxënësve iu lexohet një tekst gazetaresk në zgjedhje të arsimitarit. Është e dëshirueshme që teksti të paraqitet në projektor. Pasi të jetë lexuar teksti, hiqet nga ekrani dhe prej nxënësve kërkohet që ta ritregojnë atë që kanë mbajtur mend, por duke iu përmbajtur stilit raportues. Në atë mënyrë ata krijojnë një tekst të ri gazetaresk.

Pastaj bëhet analiza e tekstit gazetaresk origjinal dhe atij që nxënësit e kanë shkruar sipas kujtesës së tyre. Pyejtjet që duhet të marrin përgjigje janë: Sa informacione nuk janë përfshirë dhe ndonjëri prej tyre a e ndryshon thelbësisht përmbajtjen e tekstit origjinal? Çka mund të supozoni të ketë ndikuar cilat informacione do të mbahen mend, cilat do të theksohen, e cilat do të mungojnë?

Detyra 6 (për arsimin fillor e të mesëm): Stereotipa etnikë

Përshkrimi i detyrës:

Në një anë numërohen disa emra: Kire, Besim, Mustafa, Milladin, Hamdi, Gjulsen, Mira, Teuta, Ajshe, Neda.

Në anën tjetër - profesione: profesor, tregtar, pastrues, sportist, druvar, doktor, punëtor krahu, i papunë, konsultant, shitës, farmacist, kirurg.

Pa u menduar, por më shumë përmes asociacionit të parë, që do t'i vijë në mend, secili prej nxënësve duhet t'i lidhë emrat me ndonjërin prej profesioneve. Përgjigjet duhet të shqyrtohen tok dhe të shihet se a paraqiten ndofarë skemash? Ndonjëri prej emrave a paraqitet shumëfish me

çifte në disa prej profesioneve? Shumë prej nxënësve a i kanë lidhur disa prej emrave me të njëjtin profesion? Nëse po - cilat emra dhe profesione? Përse?

Kthehuni te definicionet për stereotipat. Disa prej përgjigjeve, a shprehin stereotipa të vetëdijshëm apo të pavetëdijshëm për grupe të ndryshme etnike? Nëse po - çfarë? Diskutoni këto pyetje në grupe të vogla:

A. "Të dihet një pjesëtar i grupit, është njësoj sikur të njihet i tërë grupi"

-A është ky pohim i saktë për grupin etnik të cilit ti i takon?

-A është kjo e saktë për grupet tjera etnike?

-Përse po ose përse jo? Argumentoni!

B.Si do të ndiheshe po qe se mendimi për ty mbështetet në stereotip për grupin tënd etnik?

C.Çfarë vetish ose karakteristikash theksohen me stereotipat? Përse?

Ç.Prej nga i marrim idetë që kontribuojnë drejt stereotipave për njerëzit që u takojnë grupeve të ndryshme etnike? Disa prej tyre a vijnë nga paraqitjet në media? Jepni disa shembuj nga përvoja personale se ku i keni vërejtur ato. Në TV, në gazeta, në revista, në Internet?

Secili prej grupeve, pastaj, shkurtimisht i tok këqyrjet e veta me tërë klasën dhe lejohet një diskutim i shkurtër në këtë temë.

Për detyrë shtëpie nxënësve mund t'u jepet detyra të zbulojnë dhe të shkruajnë së paku 10 shembuj të paraqitjes me stereotip në media për grupin e vet etnik dhe për të tjerët.

Çdo ushtrim mund të kryhet me këto pyetje: A ju dha kjo detyrë ide të reja? Nëse po, cilat janë ato? A do ta ndryshoni sjelljen tuaj ose fjalorin tuaj si rezultat i kësaj detyre? Nëse po – si? Kjo detyrë a do të ndikojë që më ndryshe t'i përjetoni paraqitjet e grupeve etnike (po edhe në përgjithësi) në media? Si?

Detyra 7 (për arsimin fillor e të mesëm): Stereotipizimi

Përshkrimi i detyrës:

Nxënësit mund të ndahen në disa grupe dhe në një fletë letre të japin përshkrimin e shkurtër për përfaqësuesin e racës së bardhë, të zezë, të verdhë dhe të kuqe. Përshkrimi duhet të përmbajë minimum nga 5 karakteristika për secilin prej tyre. Arsimtari duhet ta ndajë tabelën në 4 kolona

për secilën racë përkatësisht dhe t'i shkruajë karakteristikat që do t'i thonë nxënësist. Pastaj mund të zhvillohet diskutimi se sa këto karakteristika paraqesin stereotipa. Çfarë stereotipash, negativë, pozitivë? Cilat janë burimet e këtyre stereotipave - prej nga njohuritë se ato karakteristika i referohen grupit përkatës? Më së miri është kur në fund të diskutimit do t'u shfaqet ky film i shkurtër: http://www.youtube.com/watch?v=FnEpIdalWGw&feature=player_embedded

Nxënësve mund t'u jepet si detyrë shtëpie të bëjnë film sipas shembullit të filmit të shfaqur, ku do të dekonstruktojnë stereotip sipas zgjedhjes së tyre.

Detara 7a (për arsimin fillor e të mesëm): Shkatërrimi i stereotipave

Përshkrimi i detyrës:

Projekt shkollor ose detyrë shtëpie:

Qasja 1: Nxënësist në grupe (ose në mënyrë individuale) duhet të bëjnë një film të shkurtër amator (është shumë në rregull që edhe kjo të bëhet me telefonat e tyre celularë), me të cilin do të paraqesin ndonjërin prej grupeve etnike, gjini të ndryshme, orientimet seksuale, persona me nevoja të veçanta etj. Qasja duhet të jetë dykahëshe, përkatësisht të paraqes se perceptohet ky grup nga të tjerët, po dhe si ai grup e sheh vetveten.

Qasja 2: Nxënësist në grupe (ose në mënyrë individuale) duhet të bëjnë një tekst të shkurtër gazetaresk, përmes të cilit në mënyrë të ngjashme do të paraqesin ndonjërin prej grupeve etnike, gjini të ndryshme, orientimet seksuale, persona me nevoja të veçanta etj. Me këtë rast, mund të shfrytëzojnë intervistë dhe vegla të tjera: për shembull, nëse punojnë në temën me nevoja të veçanta - të intervistojnë ndonjërin prej tyre, por edhe ndonjë prej popullatës së përgjithshme dhe përgjigjet e tyre t'i integrojnë në shkrimet e tyre.

Detyra 8 (për arsimin e mesëm): Porositë nga reklamat në revista

Përshkrimi i detyrës:

Pyetini nxënësist: Si kërkojnë prindërit prej tyre që të sillen si burra! (mos qaj, bëhu i fortë, sporto etj.). A iu bëhet presion që të sillen me butësinë e femrës? (Mos i ndyj duart, merr cilësi të mira, zhvilloji interesat e vërteta për të bërë gjellë, dekorim, pastrim të shtëpisë).

Pjesa e dytë e orës vazhdon me diskutimin se si promovohet dhuna ndaj vetvetes nga ana e industrisë së modës, kur burrat dhe gratë e rrezikojnë shëndetin e tyre për të arritur standarde të pamundshme me atraktivitet dhe hajthmëri. Nxënësit njëkohsisht do të shqyrtojnë se si stereotipat për burrëri mund ta nxisin dhunën te burrat. Klasës mund t'i lexoni ose t'i distribuoni shkrimin që fokusohet në çështjet e theksuara më lart: anoreksi dhe bulimi.

Nxënësve ju jepni detyra të shtëpisë që ta analizojnë ndonjë shkrim në gazetë, që do të shërbejë analizë në grup.

Shembuj që mund të shfrytëzohen:

Paraqitet fotografia nga revista me grua të hollë. Kopje nga shkrimet në gazeta. Nxënësve u jepen kopje që përmbajnë njëfarë statistike. Mjete konkretizimi, të cilat do t'i kishit rekomanduar (videomateriale etj.).

Në këtë shkallë mund të ndihmojnë edhe vetë nxënësit, për shkak se ka dallime midis mendimeve se ndokush duket bukur dhe dëshirës për të qenë si ai/ajo. Për ne është me rëndësi që thelbësisht ta duam mënyrën se si dukemi. Tregoni fotografi nga gratë e hajthme "moderne" nga cilado qoftë revistë për femra në videoprojektor ose si doracak.

Tema për diskutim:

Si iu përmbahet dhe si jeton me standardet "ideale" ky njeri, të cilat kuptohen përmes stereotipave?

Sa është e suksesshme si grua kjo sipas këtyre normave?

Cila është lidhshmëria midis reklamave si këto dhe çrregullimit të të ushqyerit?

A konsideroni se gratë do të kishin dashur të ishin të hajthme po qe se nuk ishin të bombarduara me fotografi me gra të dobëta, sikurse janë paraqitur këto në media?

Si dallojnë standardet tona për pamjen për trupin, nga standardet për grupet tjera kulturore?

E si ka qenë kjo në periudha të ndryshme të historisë? Gruaja e hajthem a ka qenë gjithnjë ideale?

Si do t'i kishit definuar çrregullimet në të ushqyer, që njihen si anoreksi dhe bulimi?